



This project is funded  
by the European Union



## **GUIDË**

# **MBI AKSESUESHMËRINË NË INFORMACION DHE KOMUNIKIM**

Ky botim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian në kuadrin e projektit “Forcimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për zbatimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri”, i cili zbatohet nga “World Vision Albania”, “Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara” (FShDPAK), dhe “Shoqata për Mbrojtjen e të Drejtave të Personave me Aftësitë Kufizuar” (MEDPAK).

Përmbajtja e tij është përgjegjësia e vetme e ADRF dhe WVA dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Tiranë, 2020

## HYRJE

Përgatitja e këtij dokumenti ka për qëllim të udhëzojë eliminimin e pengesave apo barrierave në informacion dhe komunikim, që kufizojnë pjesëmarrjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në ushtrimin e të drejtës së tyre për akses efektiv në informacion dhe komunikim për të gjithë kategoritë e personave me aftësi të kufizuara.

Kjo guidë nuk synon të përmbajë të gjithë informacionin e disponueshëm mbi aksesueshmërinë, sikurse dhe nuk synon të mbulojë çdo aspekt të fushës.

Ky udhëzim ndihmon të gjithë individët ose organizatat të cilët dëshirojnë të krijojnë informacion të aksesueshëm në formate të ndryshme, përfshirë këtu dhe informacionin për faqet e internetit. Për këtë të fundit, ky dokument mund të konsiderohet si një pikënisje për ekspertët e teknologjisë së informacionit, pasi përmban udhëzime përmbledhëse mbi mënyrën e implementimit të faqeve web të aksesueshme, duke iu përshtatur standardeve ndërkombëtare.

Ky dokument udhëzues përqendrohet në një përshkrim të përgjithshëm të termave kryesorë; duke vazhduar me hapat që duhet të ndiqen për të bërë informacionin të aksesueshëm; e duke përfunduar me shembuj të aksesueshmërisë për formate të ndryshme. Ky dokument udhëzues është një bazë e mirë orientuese edhe për punonjësit e institucioneve të cilët duhet të përgatisin dokumente të aksesueshme.

Aksesueshmëria në këtë udhëzues përcaktohet sipas përshkrimit në nenin 9 të Konventës së Kombeve të Bashkuara si:

“...masat e duhura për të siguruar që personat me aftësi të kufizuar, ashtu si gjithë të tjerë të kenë akses në ambientet fizike, ndaj transportit, informacionit dhe komunikimit, duke përfshirë edhe teknologjitë dhe sistemet e informacionit dhe komunikimit, si dhe në facilitete apo shërbime të tjera të disponueshme apo të ofruara për publikun, si në zonat urbane dhe ato rurale”.

## **AKSESUESHMËRIA NË WEB**

Në kohët e sotme të inovacionit teknologjik, gjithsecili mund të bëhet autor i një informacioni. Është e rëndësishme që ky informacion të aksesohet nga të gjithë në varësi të mënyrës se si prezantohet. Në të kundërt krijohen barrierat për persona me aftësi të kufizuara duke i përjashtuar ata nga përfitimi i shkëmbimit të njohurive dhe dijes

Standardi WCAG 2.0 (Web Content Accessibility Guidelines) mbulon një gamë të gjerë të rekomandimeve për të bërë një faqe web të aksesueshme për një grup të gjerë të personave me aftësi të kufizuara. Duke i ndjekur këto udhëzime, përmbajtja e faqeve web do të jetë e aksesueshme nga të gjithë. Më poshtë paraqitet një përshkrim i përgjithshëm i termave si dhe hapat që duhet ndjekur me qëllim për ta bërë informacionin të aksesueshëm.

Në këtë udhëzim, informacioni përcaktohet si një mesazh ose e dhënë që komunikohet dhe i përket një çështje të caktuar. Fokusi është shpërndarja e mesazheve për të informuar personat në mënyrë që të ndërtojnë njohuri në një mjedis të përshtatshëm. Tipet e ndryshme të informacionit janë informacionet në formatin e tekstit, imazhit, audio dhe video. Këto informacione mund të shpërndahen duke përdorur kanale të ndryshme komunikimi, si p.sh. në formatin e dokumenteve elektronikë, online, video dhe materiale të printuara. Informacioni i aksesueshëm është ai informacioni që jepet në formate

të cilat lejojnë çdo përdorues të aksesojnë përmbajtjen ‘Në mënyrë të barabartë me të tjerët.’

Një nga çështjet kryesore për ta pasur një tekst të aksesueshëm është struktura e tij dhe aftësia për të naviguar në të. Në strukturat e teksteve duhet kontrolluar nëse paragrafët janë në radhën e duhur për tu ndjekur nga përdoruesit sa më lehtësisht. Një dokument i cili është i mirë strukturuar mund të konvertohet lehtësisht në formatet e preferuara nga përdoruesit, p.sh. një dokument i mirë strukturuar mund të lexohet qartazi nga lexues monitori (screen readers) ose nga teknologji të tjera ndihmuese. Sa më komplekse të jetë paraqitja (tabela, fusnota, ikona, etj.) aq më e rëndësishme është të përcaktosh rrjedhën logjike të të lexuarit në strukturë.

## Tekst i aksesueshëm

- ◆ Përdor një gjuhë të thjeshtë, e cila është e përshtatshme për dokumentin
- ◆ Përdor madhësinë 12
- ◆ Përdor shkrimin si p.sh. Aria, Helvetica ose Verdana
- ◆ Për materialet online përdor shkrimin Verdana, Tahoma dhe Trebuchet MS, të cilat janë krijuar për tu lexuar në monitor
- ◆ Lejo përdoruesit të ndryshojnë madhësinë e tekstit në materialet online
- ◆ Përdor rreshtimin nga e majta
- ◆ Për tekstet online të jetë mundësia për të naviguar dhe me tastierë (shortcuts)
- ◆ Sigurohu që ngjyrat e tekstit dhe sfondit të kenë një kumbimin të mirë kontrastesh duke mos penguar leximin.
- ◆ Sigurohu që teksti dhe grafikat e ndryshme të jenë lehtësisht të kuptueshme kur shikohen pa ngjyra.
- ◆ Shoqëroje përmbajtjen tekst me elementë ekuivalente (si fotografi, video, audio)
- ◆ Tabelat të kenë kokën dhe një përshkrim për përmbajtjen e tyre.

## Imazh i aksesueshëm

- ◆ Shmang përdorimin e imazheve të cilat nuk kanë vlerë të shtuar në informacion
- ◆ Përdor tekst alternativ për çdo element jo-tekst në përmbajtje
- ◆ Shmangni përdorimin e ngjyrave të kuqe, të gjelbër, të verdhë, dhe gri të lehtë.
- ◆ Përdor një kontrast të kuptueshëm të ngjyrave në sfond
- ◆ Shmangni sfondet me shumë imazhe, forma ose ngjyra
- ◆ Përmasat e imazheve të jenë të ndryshueshme sipas nevojës.

## Audio e aksesueshme

- ◆ Përdor ekuivalentin në tekst. Është teksti që shpërndan të njëjtin informacion si audio, pa humbur rëndësinë e përmbajtjes
- ◆ Mundëso kontrollin e volumit
- ◆ Mundëso nënvijëzimin e fjalës në tekstin ekuivalent të audios në mënyrë të sinkronizuar.
- ◆ Shmang fillimin automatik të audios
- ◆ Përdor tastierë për funksione të ndryshme mbi audio, si p.sh. “Shko përpara”, “Shko pas”, “Ndalo”, etj.

## Video e aksesueshme

- ◆ Përdor tekstin ekuivalent të videos. Syno mos të paraqiten vetëm fjalët e folura, por dhe një përshkrim se çfarë po ndodh
- ◆ Sigurohu që teksti ekuivalent të jetë i sinkronizuar me videon.
- ◆ Mundëso kontrollin e zërit dhe funksione të tjera si p.sh. “Shko përpara”, “Shko pas”, “Ndalo”, etj.
- ◆ Sigurohu që video mund të luhet në programe të ndryshme
- ◆ Sigurohu që video mund të shkarkohet
- ◆ Shmang fillimin automatik të videos.

## EASY READ

Easy Read është një mënyrë për të bërë informacionin e shkruajtur lehtësisht të kuptueshëm për personat që kanë nevoja të posaçme intelektuale. Kjo guidë do ndihmojë në prodhimin e dokumenteve easy read. Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë të aksesojnë informacionin sikurse çdo njëri tjetër. Kjo është e sanksionuar dhe nga Konventa e OKB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, si një premisë dhe e drejtë që secili shtet duhet të garantojë. Institucionet shtetërore duhet të ndërmarrin veprime shtesë me qëllim që personat më aftësi të kufizuara të kenë akses në informacion dhe të shprehin pikëpamjet e tyre.

Dokumentet me easy read duhet të përdorin një gjuhë të thjeshtë dhe informacioni të jetë i ilustruar me fotografi. Kjo i ndihmon personat me aftësi të posaçme për të kuptuar informacionin më lehtësisht. Kur adaptohet informacioni nga një dokument kompleks në easy read, është e rëndësishme që të përfshihen pikat kryesore për të cilat personat duhet të informohen.

Disa këshilla për të krijuar dokumente lehtësisht të lexueshme (easy read)

**Aa**

Përdor shkrimin me ngjyrë të zezë me madhësi të mjaftueshme për tu lexuar nga personat me aftësi të kufizuara. Këshillohet shkrimi me madhësi 16 Arial, Helvetica



Sigurohu që teksti të jetë i dukshëm, sidomos nëse përdorni ngjyrat. Bardhë e zi është përgjithësisht zgjedhje e mirë, por sigurisht mund të përdorni ngjyrat. Këshillohet ngjyra e portokalli



Krijo hapsirë në dokument për të vendosur fotografitë.



Shumica e njerëzve e ka të lehtë nëse fotografitë ndodhen në të majtë të tekstit. Përdor fotografitë në dokument kur ato kanë lidhje me fjalinë. Mos përdor shumë fotografi, pasi e bëjnë të vështirë leximin.



Shtoni një hapsirë shtesë midis rreshtave. Kjo do të bëjë tekstin më të lexueshëm. (p.sh. Zgjidhni hapsirë 1.5). Këshillohet të mos përdoren fjalë të gjata, pasi ato janë të vështira për tu kuptuar.

Dokumentet lehtësisht të lexueshme mund të jenë skedarë të mëdhenj, pasi përmbajnë fotot. Kjo mund të shkaktojë problem gjatë dërgimit me email, ose nëse kërkohet të shkarkohen nga internet. Këshillohet që të konvertohet në skedar .PDF